**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**GJYKATA E LARTË**
**KOLEGJI CIVIL**

**Nr. 11243-01019-00-2011 i Regj. Themeltar**
**Nr. 00-2017-2078 i Vendimit (102)**

**VENDIM**
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përberë nga:

| | |
|---|---|
| Artan Broci | Kryesues |
| Medi Bici | Anëtar |
| Shkëlzen Selimi | Anëtar |
| Andi Çeliku | Anëtar |
| Admir Thanza | Anëtar |

Në seancën gjyqësore të datës 28.09.2017, mori në shqyrtim çështjen që u përket palëve:

**KËRKUES:** **Shoqëria "KAPTAN METAL DIS TICARET VE NAKLIYAT AS"** *e përfaqësuar në gjykim nga av.Përparim Kalo.*

**PERSON I INTERESUAR:** **Shoqëria "SCUTARI CONSTRUCTION" Sh.p.k.,** *në mungesë.*

**OBJEKTI:** *Njohje e vendimit përfundimtar të Gjykatës së Arbitrazhit të Huaj.*

**BAZA LIGJORE:** *Ligji nr.8688, datë 09.11.200, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të Arbitrazhit " (Konventa e New York-ut 1958) Nenet 1, 2, 3 veçanërisht neni 4 dhe 5 i Konventës; Neni 393, 396, 397 dhe 399 të K. Pr. Civile.*

**Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr.22, datë 01.03.2011,** ka vendosur:
*"Pranimin e kërkesës. Njohjen e vendimit e Gjykatës së Arbitrazhit me seli në Gjenevë Zvicër datë 01.07.2010 me palë paditës Kaptan metal Dis Ticaret Ve Nakliyat A.S Turqi dhe i paditur Scutari Construction shpk, Shqipëri"*

**Kundër vendimit nr.22, datë 01.03.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë** ka paraqitur *rekurs* **personi i interesuar, "Shoqëria Scutari Construction" Sh.p.k**, me anë të cilit kërkon *prishjen e vendimit nr.22, datë 01.03.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e kërkesës ose kthimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë* për këto shkaqe*:*

- *Gjykata e apelit ka vepruar në kundërshtim me nenin 396 të K.Pr.Civile, pasi vërtetimi i paraqitur nga pala kërkuese se vendimi ka marrë formë të prerë nuk i plotëson kriteret e përcaktuar në këtë dispozitë, pasi vërtetimi vetëm përcakton se kundër këtij*

*vendimi të arbitrazhit nuk është bërë ankim deri më 5 nëntor 2010, por ai nuk tregon natyrën e formës së prerë të vendimit dhe mundësinë e tij për tu ekzekutuar.*

- *Nuk kuptohet se pse Gjykata Federale e Lozanës është autoriteti kompetent për të vërtetuar se ky vendim është i formës së prerë në kushtet kur kjo procedurë Arbitrazhi është kryer në përputhje me rregullat e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë.*
- *Gjykata e apelit nuk shprehet mbi pretendimin tonë për të sqaruar nëse në rastin konkret do të zbatohet ligji i huaj sipas nenit 220 të K.Pr.Civile dhe nëse po duhet të bëhet e ditur përmbajtja e ligjit të huaj. Gjykata nuk analizon edhe në arsyetimin e saj përmbajtjen e ligjit për të drejtën ndërkombëtare private të Federatës Zvicerane, ligj i cili përcakton kërkesën për lëshimin e një certifikate zbatueshmërie për vendimin e arbitrazhit, certifikatë që lëshohet nga gjykata përkatëse pas kalimit të afatit të ankimit.*
- *Gjykata gabon pasi afati nis nga momenti i njoftimit të vendimit. Në gjykimin në Gjykatën e Apelit përveç se nuk ka një përcaktim për certifikatën e zbatueshmërisë të vendimit nuk ka asnjë përcaktim për momentin e njoftimit të vendimit të paditurit.*

**KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË,**

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Admir Thanza; përfaqësuesin e palës kërkuese, Shoqëria "KAPTAN METAL DIS TICARET VE NAKLIYAT AS**",** av. Përparim Kalo i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr.22, datë 01.03.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, në mungesë të personit të interesuar; dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N**

**I. Rrethanat e çështjes:**

1. Nga materiale te dosjes gjyqësore rezulton se: Kërkuesi shoqëria "Kaptan Metal Dis Ticaret Ve Nakiyat A.S" është një shoqëri tregtare e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjet e shtetit Turk, me seli në Fahrettin Kerim Gokay Cad.

2. Pala e interesuar, shoqëria "Scutari Construction" sh.p.k është një shoqëri e themeluar, e regjistruar dhe që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë me seli në Tiranë.

3. Ndërmjet palëve në proces, shoqërisë "Kaptan Metal Dis Ticaret Ve Nakiyat A.S" dhe shoqërisë "Scutari Construction" sh.p.k janë nënshkruar kontratat me nr.ME/805-117/RDB datë 7 Maj 2008, nr.ME/0805-118/RDB, datë 7 Maj 2008, nr.ME/0806-145/RDB, datë 19 Qershor 2008, në të cilat palët kanë parashikuar në Neni 10: *".... nëse mosmarrëveshjet nuk zgjidhen në mënyrë miqësore, atëherë çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim që lind nga ose në lidhje me këtë marrëveshje, përfshirë vlefshmërinë, pavlefshmërinë, shkeljen ose përfundimin e marrëveshjes, do të zgjidhet nga arbitrazhi sipas Rregullave Zvicerane të Arbitrazhit Ndërkombëtar të Dhomës Zviceriane të Tregtisë... Vendi i arbitrazhit do të jetë Gjeneva/Zvicër dhe procedurat e arbitrazhit do të zhvillohen në gjuhën angleze"*

4. Për sa më sipër, Shoqëria "Kaptan Metal Dis Ticaret Ve Nakiyat A.S", lidhur me mosmarrëveshjet për ekzekutim të detyrimeve kontraktore dhe dëmshpërblimet përkatëse, në zbatim të nenit 10, i është drejtuar Gjykatës së Arbitrazhit, Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë Gjenevë, ku arbitri i vetëm me vendim datë 1 korrik 2010 ka vendosur:

*- I padituri ti paguajë shumën prej 4.625.241.90 dollarë amerikanë si dhe interesin mbi të duke filluar nga 29 Nëntori 2008 deri në pagesën e plotë me një normë që i korrespondon normës mesatare të interesit të nxjerra nga bankat shtetërore turke në depozitë njëvjeçare në dollar amerikanë.*
*- Kundërpadia e të padituri rrëzohet.*
*- I padituri duhet ti paguajë paditësit shumën prej 180.901.40 franga Zvicerane për shpenzimet e arbitrimit*

5. Kërkuesi, Shoqëria "Kaptan Metal Dis Ticaret Ve Nakiyat A.S", për të garantuar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit datë 1 korrik 2010 i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesën objekt gjykimi.

6. **Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr.22, datë 01.03.2011,** ka vendosur:
*"Pranimin e kërkesës. Njohjen e vendimit e Gjykatës së Arbitrazhit me seli në Gjenevë Zvicër datë 01.07.2010 me palë paditës Kaptan metal Dis Ticaret Ve Nakliyat A.S Turqi dhe i paditur Scutari Construction shpk, Shqipëri"*
   6.1. Në marrjen e vendimit gjykata e apelit ndërmjet të tjerash ka arsyetuar se *"..nuk ekziston asnjë pengesë ligjore e përcaktuar në dispozitën procedurale të sipërcituar që të mos lejojë dhënien fuqi të vendimit datë 01.07.2010 i Gjykatës së Arbitrazhit Gjenevë, Zvicër. Gjykimi i zhvilluar nga kjo Gjykatë (Arbitrazhi) është në pajtim të plotë me parimet bazë të legjislacionit shqiptar... në aktet e administruara në dosje del se vendimi i arbitrazhit është marrë më datën, 1 korrik 2010 dhe se për këtë vendim nuk është paraqitur ankim nga pala e paditur pranë Gjykatës Federale Zvicerane. Në dosje është administruar certifikata e datës 17 nëntor 2010 e legalizuar me vulë apostile tregon faktin se vendimi i gjykatës së arbitrazhit nuk është ankimuar. Personi i interesuar.. nuk paraqiti asnjë fakt apo provë që të vërtetonte se, nga ana e tyre është depozituar ankim pranë Gjykatës Federale Zvicerane sipas nenit 100 të ligjit zvicerian mbi të drejtën ndërkombëtare private...."*

7. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka ushtruar *rekurs* **personi i interesuar, "Shoqëria Scutari Construction" sh.p.k,** me anë të të cilit kërkon: *prishjen e vendimit nr.22, datë 01.03.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e kërkesës ose kthimin e çështjes për rigjykim në këtë gjykatë,* me shkaqet e lartpërmendura.

**II. Ligji i zbatueshëm**

8. Dispozitat e Kodit të Procedurës Civile në të cilat është parashikuar:
   8.1. **Neni 14** i K.Pr.Civile: *"Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin."*
   8.2. **Neni 16§1** i K.Pr.Civile: *"Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët".*
   8.3. **Neni 393** i K.Pr.Civile: *"Vendimet e gjykatave të shteteve të huaja njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë, në kushtet e parashikuara në këtë Kod ose në ligje të veçanta. Kur për këtë qëllim ka marrëveshje të posaçme ndërmjet*

*Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes.”*

8.4. **Neni 394** i K.Pr.Civile: *“Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur: a) sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin; b) kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t’i dhënë atij mundësi që të mbrohet; c) midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare; ç) është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë; d) i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij; dh) nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.”*

8.5. **Neni 395** i K.Pr.Civile: *“Kërkesa për t’i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj i paraqitet gjykatës së apelit. Kërkesa mund të paraqitet edhe në rrugë diplomatike kur ajo është e lejueshme nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe mbi bazën e reciprocitetit. Në këto raste, në qoftë se pala e interesuar nuk ka emëruar përfaqësues, kryetari i gjykatës së apelit emëron një avokat për të paraqitur kërkesën”.*

8.6. **Neni 396** i K.Pr.Civile: *“Kërkesës për t’i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet t’i bashkëngjiten:*
*a. kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;*
*b. vërtetim nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit, ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë;*
*c.prokura, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri”.*

8.7. **Neni 397** i K.Pr.Civile: *“Gjykata e apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394. Për kërkesën e paraqitur gjykata e apelit jep vendim.”*

9. Konventa e NewYork-ut “*Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit*”, 10 qershor 1958, hyrë në fuqi më 7 qershor 1959. Ratifikuar me ligjin nr.8688, datë 9.11.2000, “*Për aderimin e republikës së Shqipërisë në “konventën*

*për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit*" në të cilat është parashikuar:

9.1. **Neni 4 i Konventës**: *"1. Për të siguruar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit siç përmendet në nenin e mësipërm, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin duhet të paraqesë, në të njëjtën kohë me kërkesën sa vijon:*

*a. origjinalin e vendimit, të vërtetuar rregullisht ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur;*

*b. origjinalin e konventës së parashikuar në nenin 2 ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur.*

*2. Në qoftë se vendimi ose marrëveshja në fjalë nuk është hartuar në një gjuhë zyrtare të vendit ku jepet vendimi, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimit duhet të paraqesë një përkthim të këtyre dokumenteve në ato gjuhë. Përkthimi duhet vërtetuar nga një përkthyes zyrtar, ose një përkthyes i betuar, ose nga një agjent diplomatik apo konsullor".*

9.2. **Neni 5 i Konventës**: *"1. Njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohen me kërkesën e palës kundër së cilës drejtohet, vetëm në qoftë se ajo palë i paraqet autoritetit kompetent ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi,provën që:*

*a.palët në marrëveshjen që i referohet nenit 2, në bazë të ligjit të zbatueshëm për to, ishin të paafta për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme sipas ligjit, të cilit i janë nënshtruar palët ose mungon ndonjë përcaktim sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi ose*

*b.palës kundër së cilës jepet vendimi nuk i është dhënë njoftimi i rregullt për caktimin e arbitrit ose të procedurës së arbitrazhit, ose, ka qenë e paaftë për të paraqitur rastin e saj, ose*

*c.vendimi trajton një mosmarrëveshje të paparashikuar në marrëveshjen për arbitrazh ose nuk hyn në klauzolën mbi arbitrazhin ose përmban vendime për çështjet që kalojnë fushën, që i nënshtrohet arbitrazhit; megjithatë në qoftë se vendimet për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit mundtë veçohen nga ato që nuk i janë nënshtruar, ajo pjesë e vendimit e cila përmban vendime për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit, mund të njihet dhe të ekzekutohet; ose*

*d.përbërja e autoritetit të arbitrazhit ose e procedurës së arbitrazhit nuk ishte në përputhje me marrëveshjen e palëve, ose mungon një marrëveshje e tillë, nuk është në përputhje me ligjin e vendit ku është zhvilluar; ose e. vendimi nuk ka marrë formën përfundimtare për palët, ose është anuluar ose pezulluar nga organi kompetent i vendit në të cilin, ose sipas ligjit të të cilit është dhënë vendimi.*

*2. Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit mund të refuzohen gjithashtu në qoftë se autoriteti kompetent i vendit ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi konstaton se:*
*a. objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, sipas ligjit të atij vendi, ose*
*b. njohja ose ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të këtij vendi".*

**III. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson:**

10. Pala që ka regjistruar *ankimin,* **Shoqëria "SCUTARI CONSTRUCTION" Sh.P.K.,** legjitimohet *ratione personae* t'i drejtohen Gjykatës së Lartë lidhur me sa më sipër.

11. *Rekursi* është paraqitur brenda afatit ligjor, ndaj edhe legjitimohet *ratione temporis.* Gjithashtu rezulton se *rekursi* i është njoftuar palës tjetër ndërgjyqëse.

12. Në lidhje me thelbin (legjitimimi *ratione materiae*), Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se *rekursi* i paraqitur nga **Shoqëria "SCUTARI CONSTRUCTION" Sh.p.k.,** nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, të cilat motivojnë cenimin e vendimit nr.22, datë 01.03.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

13. Gjykata e Lartë, pa i hyrë analizës së provave, nga shqyrtimi i materialeve të dosjes gjyqësore, pretendimeve të parashtruara në rekurs evidenton nëse nga gjykata e apelit janë lejuar ose jo shkelje të normave procedurale dhe nëse ligji material është respektuar ose jo. Në varësi të zgjidhjes së këtyre çështjeve nga gjykata e apelit, Gjykata e Lartë, në realizim të funksionit të saj rishikues, shprehet për bazueshmërinë ose jo në ligj të vendimit të gjykatës së apelit.

14. Në shqyrtim e në vlerësim të akteve që ndodhen në dosjen gjyqësore e të administruara gjatë gjykimit, si dhe referuar shkaqeve të rekursit, Kolegji Civil vlerëson se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga gjykata e apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural.

15. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke ju referuar Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.06, datë 01.06.2011, çmon të theksoje natyrën e gjykimit me objekt *"Njohje e vendimit të gjykatës së huaj"*. Në këtë lloj gjykimi, gjykata e apelit zhvillon një gjykim të natyrës fillestare, sikurse çdo gjykatë e shkallës së parë, kjo gjykatë (gjykata e apelit) zbaton rregullat procedurale për verifikimin e rregullshmërisë formale të paraqitjes së kërkesës për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj. Nëse ka mangësi dhe të meta, gjykata e apelit i cakton kërkuesit një afat të arsyeshëm për plotësimin e tyre, në të kundërt i kthen kërkesën dhe aktet e tjera pa veprim të mëtejshëm.

16. Këto verifikime, gjykata e apelit i realizon me paraqitjen e kërkesës ose në kuadër të veprimeve përgatitore, kryesisht apo me kërkesën e palëve.

17. Në fazën e dytë, pra nëse kërkesa për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo gjykatës së huaj të arbitrazhit përmbush kushtet për rregullshmërinë formale-procedurale të paraqitjes së saj, gjykata e apelit cakton seancën gjyqësore në të cilën objekti i gjykimit

është vetëm ekzistenca ose jo e ndonjërës prej pengesave dhe ndalimeve ligjore të parashikuara nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile, neni 5 i Konventa e New York-ut "*Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit*", 10 qershor 1958, apo nga ndonjë dispozitë tjetër e posaçme për këtë qëllim, e parashikuar nga ligji ose një marrëveshje tjetër ndërkombëtare.

18. Pasi ka dëgjuar argumentet dhe prapësimet përkatëse të palëve ndërgjyqëse, në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo gjykatës së huaj të arbitrazhit[1].

19. Lidhur me rastin në gjykim, Kolegji Civil konstaton se Gjykata e Apelit në njohjen dhe dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj dhe në rastin konkret të vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Gjenevë, arbitrit të vetëm të datë 1 korrik 2010, ka zbatuar drejtë procedurat te trajtuara më lart sipas parashikimeve në dispozitat e ligjit procedural civil dhe praktikës unifikuese.

20. Kolegji Civil vëren se Gjykata e Apelit ka vendosur të njohë vendimin e gjykatës së huaj, duke i dhënë fuqi për ekzekutimin e tij në Republikën e Shqipërisë duke thirrur në gjykim palën debitore **Shoqëria "SCUTARI CONSTRUCTION" Sh.p.k.,** dhe mundësuar kësaj pale që të shprehë prapësimet dhe të paraqesë provat e saj.

---

1. Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.06, datë 01.06.2011, është unifikuar praktika gjyqësore në lidhje me gjykimet me objekt njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja dhe është arritur në përfundimin, se: "*...omissis...Gjykata e apelit duhet të verifikojë dhe, eventualisht, të kryejë të gjitha veprimet që i parashikon ligji procedural civil, Konventa e Nju Jorkut. ligji i posaçëm ose marrëveshja tjetër ndërkombëtare e zbatueshme (nëse ka të tillë), për të garantuar, edhe kryesisht, thirrjen në gjykim së të gjitha palëve debitore që rezultojnë nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së huaj ose gjykatës së huaj të arbitrazhit që kërkohet t'i jepet fuqi nga ajo gjykatë e apelit.31.2 Në shqyrtimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo të gjykatës së huaj të arbitrazhit, gjykata e apelit zbaton rregullat e gjykimit të shkallës së parë.*
*Mes të tjerave, sikurse vepron gjykata e shkallës së parë, me paraqitjen e kërkesëpadisë apo edhe nëpërmjet kryerjes së veprimeve përgatitore, gjykata e apelit paraprakisht verifikon përmbushjen e kushteve dhe kritereve formale të paraqitjes së kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj ose të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Posaçërisht, gjykata e apelit verifikon nëse kërkesa, sipas rastit, plotëson kushtet paraprake formale të parashikuara nga neni 395 e 396 i Kodit të Procedurës Civile, neni 4 i Konventës së Nju Jorkut apo që përmbahen në ligje të tjera të posaçme ose akte të së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme për çështjen në gjykim. 31.4 Nëse kërkesa për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj ose të gjykatës së huaj të arbitrazhit ka mangësi dhe të meta, gjykata e apelit i cakton kërkuesit një afat të arsyeshëm për plotësimin dhe ndreqjen e tyre. Gjykata e apelit kthen kërkesën dhe aktet e tjera pa veprim, nëse pala kërkuese, brenda afatit që i është caktuar, nuk plotëson dhe ndreq mangësitë dhe të metat formale të kërkesës. 31.5 Nëse kërkesa për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo të gjykatës së huaj të arbitrazhit përmbush kushtet për rregullshmërinë formale-procedurale të paraqitjes së saj, gjykata e apelit cakton seancën gjyqësore në të cilën objekti i gjykimit është vetëm ekzistenca ose jo e ndonjërës prej ndalimeve a pengesave ligjore të parashikuara nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile, neni 5 i Konventës së Nju Jorkut apo nga ndonjë dispozitë tjetër e posaçme për këtë qëllim, e parashikuar nga ligji ose një marrëveshjeje ndërkombëtare. Në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo gjykatës së arbitrazhit të huaj.(…)."*

21. Lidhur me pretendimin e personit të interesuar **Shoqëria "SCUTARI CONSTRUCTION" Sh.p.k.,** *pasi nuk është e provuar marrja formë e prerë e këtij vendimi* dhe për këtë arsyet mosnjohja e vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Gjenevë, arbitrit të vetëm të datë 1 korrik 2010, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i gjykatës së apelit e ka marrë dhe analizuar këtë fakt si një nga parakushtet për njohjen e vendimit të huaj, duke ju referuar ligjit *për Gjykatën e Federale ku në nenin 100 të tij janë përcaktuar afatet e ankimit sipas të cilit: "Ankimi kundër një vendimi arbitrazhi duhet të depozitohet pranë gjykatës federale brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit.*

22. Lidhur me këtë pretendim gjykata e apelit ka administruar dhe Vërtetimin e Sekretarisë së Përgjithshme të Gjykatës Federale Lozanë, Zvicër të datës 5 nëntor 2010 *(me vulë apostile)* në përmbajtje të cilës rezulton se:*"...omissis...se në Gjykatën Federale deri më sot nuk është bërë asnjë ankesë kundër vendimit përfundimtar të "Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Gjenevës"që nga data 1 Korrik në drejtim të Kaptan Metal Dis Ticaret Ve Nakliyat AS (Turqi) deklaruar hapur kundër Scutari Construction (Albania).*

23. Nga ana tjetër personi i interesuar nuk ka arritur të provojë me prova shkresore ushtrimin e ankimit kundër vendimit objekt gjykimi pranë Gjykatës Federale Lozanë, Zvicër, duke pasur dhe barrën e provës për një pretendim të tillë.

24. Gjithashtu, lidhur me pretendimin tjetër se *në gjykimin në Gjykatën e Apelit nuk ka asnjë përcaktim për momentin e njoftimit të vendimit të paditurit*, Kolegji e vlerëson të pabazuar. Konkretisht duke ju referuar gjykimit në Gjykatën e Arbitrazhit, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Gjenevë, me arbitër të vetëm, pala e paditur ka qenë prezent në këtë gjykim dhe jo vetëm kaq por ka ngritur edhe kundërpadi.

25. Për sa sipër Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, arrin në përfundimin se vendimi nr.22, datë 01.03.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është rrjedhojë e respektimit dhe e zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore procedurale përkatëse dhe për këtë shkak duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE**

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 485 shkronja "*a*" të Kodit të Procedurës Civile,

**V E N D O S I**

Lënien në fuqi të vendimit nr.22, datë 01.03.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Tiranë, më 28.09.2017